



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.29/2018  
Prishtinë, më 1.6.2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila dhe Bilall Sherifi, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Molliqaj, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dardan Abazi – INDEP dhe Sahadete Zogaj – Kosova/ Press.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.5.2018;**
- 3.Votimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2017;**
- 4.Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale;**
- 5.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave – ARH për vitin 2017;**
- 6.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;**
- 7.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare;**
- 8.Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Sala Berisha Shala, kryetare,** propozoi që pika 5 (pestë) e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës “Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2017” për shkak se na kanë njoftuar përfaqësuesit ARH-së, se nuk kanë mundësi të marrin pjesë sot në mbledhje.

*Rendi i ditës u miratua, me ndryshimin e propozuar nga kryetarja.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.5.2018**

*Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 22.5.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Votimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM për vitin 2017**

**Kryetarja** theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës është shterur debati në mbledhjen e fundit dhe e hodhi për votim.

*Komisioni njëzëri nxori këtë:*

### *Rekomandim*

*1. I rekomandohet Kuvendit të miratohet Raporti vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2017.*

*2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja Sala Berisha -Shala, kryetare e komisionit.*

## **4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale**

**Kryetarja** tha se Raporti me amendamente i Projektligjit për Miniera dhe Minerale, sipas procedurës së Rregullores së Kuvendit, është i gatshëm për lexim të dytë. Njoftoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka parashtruar dy amendamente si vijon;

### *Amendamenti 1*

*Neni 58, paragrafi 3, ndryshohet si vijon:*

*3. Pagat dhe shtesat e personelit të KPMM-së, caktohen në pajtueshmëri me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Pagat e nëpunësve civilë.*

Me arsyetimin se stafi i administratës së Agjencive të Pavarura, konsiderohen shërbyes civilë, andaj pagat dhe shtesat e të punësuarve të KPMM-së, deri në nxjerrjen e Ligjit për Pagat, të rregullohen në pajtueshmëri me Ligjin për Shërbimin Civil, Ligjin për Pagat e nëpunësve civilë dhe legjislacionin sekondar për shërbimin civil.

Po ashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka rekomanduar që me qëllim të harmonizimit me

këtë amendament të propozuar, të ndryshojë nenet e Projektligjit, që statusi dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës të të punësuarve të KPMM-së, të bëhet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

#### *Amendamenti 2*

*Neni 59, pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri 2, me tekstin si vijon:*

*2. Të hyrat e mbledhura nga KPMM-ja, në formën të taksave, licencave dhe tarifave tjera, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, të cilat i tejkalojnë planifikimet buxhetore të KPMM-së, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.*

Me arsyetimin se të hyrat shtesë që mblidhen, të cilat i tejkalojnë planifikimet buxhetore të KPMM-së, duhet të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

*Komisioni aprovoj dy Amendamentet e Komisionit për buxhet dhe financa, si dhe rekomandimin që statusi dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës i të punësuarve të KPMM-së, trajtohet më Ligjin për shërbimin civil, dhe autorizoi stafin e Komisionit që të hartojë amendamente të reja në këtë frymë.*

Lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të fshihet amendamenti 28, dhe të mbetet teksti siç është në Projektligj, si dhe të fshihet amendamenti 29 i propozuar nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, pasi që përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Kryetarja tha së rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është që amendamentet e propozuara duhet të jenë në harmoni më Ligjin për Menaxhimin Financave Publike, është kuptueshëm së duhet të përshtatën më këtë ligj, por në amendamentin e propozuar nga Komisionin Funkcional që “20 (njëzet) % e rentës minerare të rialokohet nga buxheti qendror për buxhetin e Komunës ku zhvillohet aktivitetit mineral, i dedikuar në mënyrë specifike në zhvillim të komunitetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit”, kërkoj që të mbetet kështu sepse në të ardhmen mund të përfitojnë të gjitha komunat ku do që zhvillohet aktiviteti mineral. Tanimë kemi edhe dy ligje në fuqi që përfitojnë me 20 (njëzet) % e rentës minerare, pra Ligji për Trepçën dhe Ligji për Obiliqin.

**Hykmete Bajrami** tha pasi që amendamenti i komisionit është kundërshtim më Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, siç është thënë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, është mirë që të gjendet një dispozitë ku mund t’iu mundësojmë komunave të zhvillojnë politikat për mbrojtje të ambientit, pra ato komuna dhe zona ku ushtrohet aktivitet mineral – të futët një dispozitë ku thuhet se: më ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë hyn në fuqi neni 45. Prandaj e mbështesë arsyetimin e propozuar nga Komisionit për Buxhet dhe Financa.

**Mimoza Kusari-Lila** tha që është mirë që t’i trajtojmë gjitha komunat që kanë aktivitetet mineral dhe që të ndahet buxhet për këto zona ku ushtrohet aktivitetet minerare dhe të trajtohen më mirë në aspektin e mjedisit që po ju shkaktohet nga mbetjet minerale. Prandaj, për këto zona, duhet të ndahet buxhet për t’i rehabilituar mjediset ku janë shkaktuar dëme ambientit.

**Dardan Sejdiu** tha që në parim duhet t’i trajtojmë gjitha komunat njëjtë në tërë territorin Republikës së Kosovës dhe jo në aspektin etnik, kërkohet që të ndahet buxhet. Parim thelbësor

është e mira e përgjithshme dhe ne duhet të sigurohemi që po bëjmë ligjin më të mirë për minierat dhe mineralet për gjithë vendin.

**Kryetarja** propozoi që rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, për amendamentin 28 komisionit, të jetë pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL dhe të mbetet ashtu siç e ka propozuar Komisioni FunkSIONAL – pra për amendamentin 28, ndërsa amendamentin 29 nuk e ka përkrahur as komisioni.

*Më shumicë votash, propozimi i kryetares, u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, më 4 (katër) vota për, 1 (një) kundër dhe 1 (një) abstenim, komisioni nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-027 për Miniera dhe Minerale;*
- 2. Raporti me rekomandime procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

## **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe**

**Kryetarja** tha se grupi i punës e ka amendamentuar këtë projektligj dhe ka paraqitur raport me amendamente, ku ia dha fjalën deputetit, z. Dardan Sejdiu, si kryesues i grupit punues ta paraqesë raportin më amendamente.

**Dardan Sejdiu** tha se grupi punues së bashku më zyrtar të ministrisë, ekspert të zyrës së BE-së, stafin e komisionit, e ka përfunduar shqyrtimin e Projektligjit për Masat Mbrojtëse në Importe, dhe gjitha amendamentet janë harmonizuar dhe përshtatur më Direktivat e BE-së, dhe rregullat e OBT-së. Gjithsej janë hartuar 38 amendamente, por kemi një propozim teknik tek amendamenti 1 fjala “drejtpërdrejtë” të fshihet por edhe tërë tekstin e Projektligjit. Ai propozoi që nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, t’i votojmë në bllok.

*Propozimi i z. Sejdiu u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, unanimisht komisioni nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1.Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;*
- 2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

*Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.*

## **6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare**

**Kryetarja**, në cilësinë e kryesueses të këtij grupi punues, tha se grupi i punës e ka përfunduar amendamentimin dhe nuk ka pasur ndryshime substanciale në projektligji dhe kemi miratuar 23 amendamente, kryesisht janë të aspektit tekniko-juridik. Ajo propozoi që, nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, t'i votojmë në bllok.

*Propozimi i znj. Berisha Shala u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, me 5 ( pesë) vota për dhe 1 (një) kundër, komisioni nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*1.Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare.*

*2.Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

*Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverballi.*

## **7. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Mimoza kusari-Lila**, lidhur më temat energjisë, propozoi që të ftohet Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, që është në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të na njoftojnë lidhur më dorëheqjen e drejtorit të KEK-ut, ose komisioni të vendosë për ta vizituar KEK-un.

**Dardan Sejdiu** tha që pajtohet së pari të ftohet Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, pastaj ministri i Zhvillimit Ekonomik në Komision, për të raportuar lidhur më temat energjisë, po ashtu dhe Kryeministrin mund ta ftojme interpelancë në Kuvend.

**Kryetarja** tha që pajtohet më z. Kusari –Lila për ta vizituar ndërmarrjen publike KEK për t' u njoftuar më hollësisht më funksionimin e KEK-ut. Pasi që edhe në Planin e Punës se Komisionit për këtë vit e kemi të paraparë vizitën në KEK.

*Propozimi i znj. Kusari-Lila u përkrah nga komisioni.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:35.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**  
-----  
**Sala BERISHA SHALA**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;**

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

**Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;**

**Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe;**

**Datë: 1.6.2018, Prishtinë;**

---

–

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 11.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoit Projektligjin nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

**Amendamenti 1**

Neni 1, riformulohet si në vijim:

1. Një masë mbrojtëse mund të zbatohet për një produkt vetëm nëse është përcaktuar sipas dispozitave të këtij Ligji, se produkti i tillë është importuar në sasi aq të shtuar, absolute apo relative në prodhimin vendor, dhe/apo me ato afate apo kushte që shkaktojnë ose kërcënojnë të shkaktojnë dëmtim serioz në industrinë vendore e cila prodhon produkte të ngjashme apo konkurruese.

2. Masat mbrojtëse zbatohen për një produkt që importohet, pavarësisht origjinës së tij.

**Amendamenti 2**

Neni 2, riformulohet si në vijim:

1. Ky ligj nuk përjashton miratimin apo zbatimin e ndalimeve, dhe/apo kufizimeve sasiore të parashikuara me nenin 26 të këtij Ligji.

2. Ky ligj nuk përjashton zbatimin e rregullave mbrojtëse të përfshira në marrëveshjet e lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve të treta. Masat mbrojtëse rregullohen me dispozitat e marrëveshjes përkatëse, të cilat do të zbatohen sipas rastit përmes dispozitave të këtij ligji.

3. Dispozita e Marrëveshjes mbi Masat Mbrojtëse së OBT gjithashtu merren parasysh gjatë interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji.

### **Amendamenti 3**

Neni 3, nënparagrafi 1.1. riformulohet si në vijim:

**1.1** Industria vendore – prodhuesit si tërësi të një produkti të ngjashëm ose drejtpërdrejtë konkurrues të cilët veprojnë në Republikën e Kosovës, apo ata prodhimi kolektiv i produkteve të ngjashme apo konkurruese të të cilëve përbën një pjesë të madhe të prodhimit të përgjithshëm vendor.

### **Amendamenti 4**

Neni 3, nënparagrafi 1.2. ndryshohet si në vijim:

**1.2** Hetim – procedurë për gjetjen e fakteve dhe efektit të importeve të një produkti të caktuar për të përcaktuar nëse sasi të rritje të importeve dhe kushtet nën të cilat ato ndodhin shkaktojnë dëmim apo kërcënim për të shkaktuar dëmim serioz tek prodhuesit vendor të produkteve të ngjashme apo konkurruese.

**1.2.1** prodhuesit vendor të produktit të ngjashëm apo drejtpërdrejtë konkurrues;

**1.2.2** shoqatat tregtare apo të biznesit të Kosovës, shumica e anëtarëve të të cilëve janë prodhues apo importues të produktit të ngjashëm apo drejtpërdrejtë konkurrues në Republikën e Kosovës;

### **Amendamenti 5**

Neni 3, nënparagrafi 1.3.5. fjalia “apo/ose drejtpërdrejtë konkurruese” zëvendësohet me fjalën “apo/ose konkurruese” dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

### **Amendamenti 6**

Neni 3, nënparagrafi 1.5. ndryshohet si në vijim:

**1.5.** Dëm serioz – dëmim i konsiderueshëm dhe i përgjithshëm në pozicionin e industrisë vendore;

### **Amendamenti 7**

Neni 3, nënparagrafi 1.9. ndryshohet si në vijim:

**1.1.** Ad valorem – nënkupton taksën doganore që llogaritet si përqindje e vlerës së produktit.

## **Amendamenti 8**

Neni 4, ndryshohet si në vijim:

1. Masat mbrojtëse janë të përkohshme dhe përbëjnë tarifën mbrojtëse ad valorem, të llogaritur sipas vlerës së produktit të importuar, e cila mund të zbatohet edhe përmes kuotës tarifore në importet e produktit të ngjashëm apo drejtpërdrejtë konkurrues. Masat mbrojtëse janë të përkohshme dhe përbëjnë tarifën mbrojtëse ad valorem, të llogaritur sipas vlerës së produktit të importuar, e cila mund të zbatohet edhe përmes kuotës tarifore në importet e produktit të ngjashëm apo konkurrues.
2. Masat mbrojtëse për produktet e importuara në territorin e Republikës së Kosovës zbatohen vetëm nëse është përcaktuar, përmes një hetimi të kryer sipas dispozitave të këtij ligji, se produkti i hetuar është importuar në territorin e Republikës së Kosovës në sasi aq të rritur dhe në kushte të tilla që shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëm serioz tek prodhuesit e produkteve të ngjashme ose konkurruese në Republikën e Kosovës.

## **Amendamenti 9**

Neni 5, në nënparagrafet 2.1.;2.2.;2.3.;2.4.;2.5.; dhe 2.6.; pas fjalës “Ministria” shtohet fjala “përkatëse”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit.

## **Amendamenti 10**

Neni 6, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Konsultimet për masat mbrojtëse ndërmjet Ministrisë dhe industrise vendore mund të bëhen pasi kërkesa të jetë dorëzuar nga ana e industrisë vendore dhe para inicimit të një hetimi me rastin e një kërkesë me shkrim nga prodhuesit apo me inicimin e Ministrisë pas konsultimit me Komisionin.

## **Amendamenti 11**

Neni 6, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

3. Çështjet rreth trendëve dhe kushteve të importimit të produktit të hetuar për gjendjen ekonomike dhe komerciale të lidhur me të, si dhe për masat potenciale që do të mund të zbatohen dhe për procesin dhe kërkesat për të hapur një hetim shqyrtohen gjatë konsultimeve.

## **Amendamenti 12**

Neni 7, riformulohet si në vijim:

1. Procedurat e zbatimit të masave mbrojtëse iniciohen me anë të kërkesës me shkrim nga apo në emër të një apo më shumë prodhuesve të produkteve të ngjashme apo drejtpërdrejtë konkurruese, të regjistruara në Republikën e Kosovës.



2. Kërkesa me shkrim konsiderohet si e dorëzuar nga ose në emër të prodhuesve vendor vetëm nëse mbështetet nga ata prodhues vendor të cilët së bashku përbëjnë një pjesë të madhe të prodhimit të përgjithshëm të produkteve të ngjashme apo drejtpërdrejtë konkurruese;

3. Në raste të veçanta, Ministria mund të iniciojë hetimin, pa pasur kërkesë me shkrim nga ose në emër të industrise vendore, me nismën e saj vetanake pas konsultimeve me Komisionin në bazë të dëshmive të mjaftueshme se produktet e importuara në territorin e Republikës së Kosovës është në sasi të rritur dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dëm serioz prodhuesve të produkteve të ngjashme ose drejtpërdrejtë konkurruese në Republikën e Kosovës.

### **Amendamenti 13**

Neni 8, nënparagrafi 1.3.riformulohet si në vijim:

1.3 Lista e të gjithë prodhuesve të njohur për parashtruesin e kërkesës që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës të cilët prodhojnë produkte të ngjashme apo konkurruese;

### **Amendamenti 14**

Neni 8, nënparagrafi 1.4.riformulohet si në vijim:

1.4 Vëllimi dhe vlera e prodhimit të përgjithshëm vendor të produktit të ngjashëm apo drejtpërdrejtë konkurrues dhe pjesa e tregut të produktit të parashtruesit të kërkesës dhe prodhuesve tjerë, krahasuar me prodhimin e përgjithshëm vendor;

### **Amendamenti 15**

Neni 9, nënparagrafi 2.6 fshihet.

### **Amendamenti 16**

Neni 9, nënparagrafi 2.9.1 fshihet.

### **Amendamenti 17**

Neni 9, nënparagrafi 2.9.2 fshihet.

### **Amendamenti 18**

Neni 11, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Hetimi bëhet brenda afatit prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh.

### **Amendamenti 19**

Neni 12, paragrafi 3, riformulohet si në vijim:

3. Vazhdimi i afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve mund t'i jepet palës për dorëzim të përgjigjeve dhe do të aprovojë vazhdimin e afatit nëse ka arsye të bazuar.

### **Amendamenti 20**

Neni 12, paragrafi 6 fshihet.

### **Amendamenti 21**

Neni 12, paragrafi 3 riformulohet si në vijim:

3. Konsultimet kryesohen nga një përfaqësues i autorizuar i Ministrisë, i cili do të sigurojë se konfidencialiteti i informatave që paraqesin sekret tregtar apo shtetëror (zyrtar) do të ruhet, si dhe t'i ofrojë mundësi të barabarta të gjitha palëve për të paraqitur pikëpamjet e tyre. Ministria bën protokollet e konsultimeve, të cilat menjëherë do të vendosen në dosjen publike, me përjashtim të informatave, në përputhje me Nenin 24 të këtij Ligji.

### **Amendamenti 22**

Neni 15, pas nënparagrafit.1.4.8. i shtohen edhe dy nënparagrafë të tjerë:

1.4.9.kthimi i kapitalit të investuar

1.4.10. qarkullimin e parasë

### **Amendamenti 23**

Neni 15, nënparagrafi 1.5. riformulohet si në vijim:

1.5 Faktorët përveç trendeve në importe që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë dëm tek industria vendore

### **Amendamenti 24**

Neni 15, pas paragrafit 1, shtohet një paragraf i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Kur faktorët përveç importeve të rritura i shkaktojnë njëkohësisht dëm industrisë vendore, dëmi i tillë nuk i mvshet importeve të rritura

### **Amendment 25**

Neni 16, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Nëse me anë të hetimeve, Ministria pas konsultimit me komisionin konstaton se masat mbrojtëse nuk janë të nevojshme, Ministria merr vendim për përfundimin e hetimit.

### **Amendment 26**

Neni 16, paragrafi 3 fshihet.

### **Amendment 27**

Neni 16, paragrafi 4 fshihet.

### **Amendamenti 28**

Neni 16, nënparagrafi 5.7 fshihet.

### **Amendamenti 29**

Neni 18, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Masat mbrojtëse të përkohshme përcaktohen me vendim të Ministrisë përkatëse së Republikës së Kosovës nëse rekomandohen nga komisioni në bazë të një përcaktimi paraprak se ka provë të konsiderueshme se rritja e importeve të produktit të hetuar ka shkaktuar ose kërcënuar të shkaktojë dëm serioz.

### **Amendamenti 30**

Neni 18, paragrafi 2 riformulohet si në vijim:

2. Masat mbrojtëse të përkohshme zbatohen kur:

- 2.1. në rrethana vendimtare, ku vonesa do të shkaktojë dëm i cili vështirë do të riparohet, duke ndërmarrë veprime të nevojshme të menjëhershme; dhe,
- 2.2. ku një përcaktim paraprak ofron dëshmi të qartë se, në bazë të të dhënave të qarta paraprake, vërtetohet se importet e rritura kanë shkaktuar apo kërcënojnë të shkaktojnë dëm serioz.

### **Amendamenti 31**

Neni 18, paragrafi 5 riformulohet si në vijim:

5. Produkti i cili është objekt i një mase mbrojtëse të përkohshme mund të importohet në territorin e Republikës së Kosovës për qarkullim të lirë pas pagimit të detyrimeve për masat mbrojtëse të përkohshme të vendosura me vendim të *Ministrit*, apo pas dhënies së garancionit apo garantimit tjetër ekuivalent të pagesës.

### **Amendamenti 32**

Neni 19, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Nëse Ministria pas një hetimi të kryer sipas dispozitave të këtij ligji, konstaton se produkti i hetuar është duke u importuar në territorin e Republikës së Kosovës në sasi të rritur dhe në kushte të tilla që shkakton ose kërcënon t'i shkaktojë dëm serioz prodhuesit, Ministria publikon njoftim publik në Gazetën Zyrtare për zbatimin e masës mbrojtëse përfundimtare. Masa

mbrojtëse shqiptohet nëse në bazë të provave objektive tregohet ekzistenca e lidhjes rastësore ndërmjet importeve të rritura të produktit përkatës dhe dëmtimit serioz apo kërcënimit të tij.

### **Amendamenti 33**

Neni 21, paragrafi 2 riformulohet si në vijim: 2. Ministri e merr vendimin për vazhdim apo tërheqje të masës mbrojtëse

### **Amendamenti 34**

Neni 22, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Masa mbrojtëse mund të zbatohet sërish në importin e një produkti të caktuar, vetëm pas dy (2) vjetëve nga skadimi i masës mbrojtëse të zbatuar.

### **Amendamenti 35**

Neni 23, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2. Duke marrë parasysh kërkesën për informata konfidenciale për masat mbrojtëse, dosja duhet të përfshijë:

- 2.1. të gjitha raportet publike që kanë të bëjnë me hetim apo rishikim;
- 2.2. të gjitha materialet, përfshirë pyetësorët, përgjigjet dhe njoftimet me shkrim të paraqitura në Ministri;
- 2.3. të gjitha informacionet tjera të hartuara apo të marra nga Ministria, përfshirë raportet e verifikimeve të kryera, dhe
- 2.4. dokumentet tjera të cilat konsiderohen të jenë konfidenciale për publikim.

### **Amendamenti 36**

Neni 24, paragrafi 6 riformulohet si në vijim:

6. Dispozitat e mësipërme nuk pengojnë Ministrinë dhe Komisionin të përdorin të dhënat e përmendura në paragrafet e mësipërm të këtij Neni si referencë nëse ju nevojiten për informata të përgjithshme; duke marrë parasysh interesin e ligjshëm të personave përkatës fizik dhe juridik që sekretet e tyre afariste nuk duhet të zbulohen.

### **Amendamenti 37**

Neni 25 fshihet.

### **Amendamenti 38**

Neni 27, riformulohet si në vijim

“Çdo palë e interesuar që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, apo të cilit iu ka refuzuar kërkesa apo rishikimi i kryer nga Ministria dhe Komisioni ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente me të cilën kërkon nga gjykata rishikimin e një veprimi ose *vendimi të Ministrisë*. Ankesa duhet të dorëzohet brenda dyzet e pesë (45) ditësh kalendarik pas pranimit të njoftimit nga pala e interesuar për veprimin ose vendimin përkatës”.

### **Amendamenti 39**

Neni 28, riformulohet si në vijim

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria mund të nxjerr akte nënligjore në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Kryetarja e Komisionit**

**Sala BERISHA SHALA**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;**

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integrime Evropiane;

**Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;**

**Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare;**

**Datë: 1.6.2018, Prishtinë;**

---

—

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 11.6.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

**Amendamenti 1**

Neni 1, paragrafi 2, ne rreshtin e parë pas fjalës “është shtohet fjala “pjesërisht”.

**Amendamenti 2**

Neni 3, nënparagrafi 1.1. i shtohet teksti si vijon “visa vi edhe dërgesat e faturave, raporteve, pasqyrave të llogarive bankare;”.

**Amendamenti 3**

Neni 3, nënparagrafi 1.3. ndryshohet si vijon:

1.3. **Dërgesa e regjistruar** – dërgesë postare që regjistrohet nga ofruesi i shërbimit postar kundrejt një pagese fikse për të garantuar dorëzimin e dërgesës postare dhe dëmshpërblimin në rast të humbjes, grabitjes apo vjedhjes;

#### **Amendamenti 4**

Neni 3, nënparagrafi 1.4. fjala “transmetohet” zëvendësohet me “bartët”.

#### **Amendamenti 5**

Neni 3, pas nënparagrafit 1.4. shtohet një nënparagraf i si si vijon:  
“Shërbimi korrier” - shërbimi derë më derë, pranimi i dërgesës në adresën e dërguesit dhe dorëzimi i saj në adresë të marrësit pa ndërprerë aktivitetin me ndonjë veprim tjetër;

#### **Amendamenti 6**

Neni 10, nënparagrafi 2.2. pesha e specifikuar “dhjetë (10) kg” zëvendësohet me “tridhjetë e një kg e pesëqind gram (31.5);”.

#### **Amendamenti 7**

Neni 11, ndryshohet si vijon:

Për sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar, Autoriteti cakton një ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

#### **Amendamenti 8**

Neni 13, nënparagrafi 2.1., fjalia “me peshë deri në pesëdhjetë (50) gram”, zëvendësohet me “pa limit peshe”.

#### **Amendamenti 9**

Neni 13, paragrafi 3, i shtohet fjalia “të dërgesave të shpejta”.

#### **Amendamenti 10**

Neni 15, paragrafi 7, fshihet fjala “nëse”.

### **Amendamenti 11**

Neni 20, paragrafi 8, pas fjalës “kërkesës” shtohet fjalia “për njoftim”.

### **Amendamenti 12**

Neni 20, nënparagrafi 10.3, riformulohet si vijon:  
10.3. ofruesi i shërbimit postar ka ndërruar jetë;

### **Amendamenti 13**

Neni 20, nënparagrafi 10.3, riformulohet si vijon:  
10.6. ofruesi i shërbimit postar nuk ka dorëzuar raporte për ofrimin e shërbimit postar tek Autoriteti brenda një viti;

### **Amendamenti 14**

Neni 20, nënparagrafi 10.7, fjala “vendbanimin” zëvendësohet me “adresën”.

### **Amendamenti 15**

Neni 21, paragrafi 2 fshihet.

### **Amendamenti 16**

Neni 24, paragrafi 2, fjala “Autorizimi” zëvendësohet me “Autoriteti”.

### **Amendamenti 17**

Neni 25, paragrafi 1 fshihet.

### **Amendamenti 18**

Neni 29, paragrafi 3, fjala “objekteve” zëvendësohet me “dërgesave”.

### **Amendamenti 19**



Neni 37, korrigjohet numri i Kapitullit VII dhe të bëhet Kapitulli VIII, si dhe deri Kapitulli XII të bëhet XI; Kapitulli XIII të bëhet XII; Kapitulli XIV të bëhet XIII; Kapitulli XV të bëhet XIV; dhe Kapitulli XVI të bëhet XV.

### **Amendamenti 20**

Neni 47, nënparagrafi 2.1. riformulohet si vijon:

2.1. humbje apo dëmtim të plotë;

### **Amendamenti 21**

Neni 55, nënparagrafi 1.3. riformulohet si vijon:

“1.3. më të gjatë kohor, nëse Autoriteti konsideron se natyra e parregullsisë kërkon afat më të gjatë kohor për rregullim”.

### **Amendamenti 22**

Neni 58, nënparagrafit 3.2. riformulohet si vijon:

“3.2 nga tridhjetë (30.00) deri në dy mijë (2,000.00) Euro, për të gjitha shkeljet e kryera nga një person fizik dhe nga personi përgjegjës i personit juridik”.

### **Amendamenti 23**

Neni 61 paragrafi 2 fshihet.

**Kryetarja e Komisionit**

**Sala BERISHA SHALA**